



Në bazë të neninit 7.pika 2. Statutit të KRU”Hidroregjioni jugor”Sh.A., me datë 03.02.2011, Bordi të Drejtorëve KRU”Hidroregjioni jugor”Sh.A.me seli në Prizren, aprovoi këtë:

Rregullore mbi korigjimin e borxhëve nga ankesat e konsumatorëve

I

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e qështjeve rreth korigjimit të borgjeve të konsumatorëve, borgje te cilat konsumatori i refuzon të paguaj dhe bën ankesë me shkrim .

II

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve ka për detyrë që ankesat me shkrim të konsumatorëve, të ju përgjigjet me shkrim mbrenda një afati sa më të shkurtër kohor dhe të mos kalojë 15 ditë nga dita e pranimit të ankesës me shkrim nga ai.

III

Në rastet kur konsumatori me kontratë të shitblerjes dëshmon se është blerës i pronës që ka trashëgu borxh nga shitësi i pronës (shtëpi , banes), ai borxh duhet të rregullohet në mes shitësit dhe blerësit por gjithsesi borxhi duhet të jetë zero para ndërrimit të emrit të konsumatorit.

Ç’kyçjen nga rrjeti i ujësjellsit nuk e ndalon arsyeja pse blerësi nuk ka qenë shfrytëzues i shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

IV

Në rastet kur ka rrjedhje të mbrendshme (mbrenda orës dhe ora e ka regjistru harxhimin e ujit) dhe konsumatori ankohet per vleren e rritur të fatures, atëherë ekipi për detektim duhet të verifikoj rastin në teren dhe të përpiloj një raport ku konstatohet se ka pas rrjedhje të mbrendshme. Në këto raste borgji për periudhën kur ka pas rrjedhje i ngelet konsumatorit që ta paguajë.

V

Në rastet kur konsumatori paraqet ankesë për faturim paushall, kërkon që ti zbritet vlera e borxhit, nuk lejohet ti zbritet borgji për periudhën e kaluar, mirëpo konsumatori obligohet që të vendos ujëmatësin dhe të filloj pagesën e hargjimit real të shërbimeve të ujësjellsit.Pas vendosjes së ujëmatësit bëhet nxjerrjet një mesatare e shpenzimit të ujit dhe këto shpenzime ngarkohet retroaktivisht prej datës së paraqitjes së ankesës.

VI

Për konsumatorët që jetojnë nën asistencë sociale, familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës nuk mund të falet borxhi për shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit përderisa kjo qështje nuk rregullohet në nivel Qeveritar. Kjo kategori e konsumatorëve nuk do të ç'kyqet nga rrjeti i ujësjellsit si rezultat i mospageses, vetëm nëse e dëshmon dokumentacionin përkatës. Nëse konstatohet keqpërdorim nga ana e kësaj kategorie të konsumatorëve atëherë do të mirren masa ndaj tyre.

VII

Nuk mund të korigjohet borgji i akumuluar nga taksa fikse e faturuar.

Një konsumator mund të pasivizohet në rastet kur:

- paraqet kërkesë me shkrim për ndërprerje të shfrytëzimit të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit
- paguhet në tërësi borxhi të akumuluar nga ana e konsumatorit
- nga ekipi i kontrollës përpilohet procesverbali për ç'kyçje, bëhen fotografi dhe ç'kyçet nga rrjeti

VIII

Konsumatorët që shfrytëzojnë lokalet me qira e që kanë trashëguar borxhe ndaj KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a, këtë qështje duhet ta rregullojnë me qiradhënësin (pronarin e lokalit). Arsyeja pse nuk është borgji i tyre nuk mund ta parandaloj ç'kyçjen e tij nga rrjeti i ujësjellsit si rezultat i borxhit.

IX

Te rastet kur ka gabime gjatë leximit, gabimet teknike, permutacion gjatë shtypjes së faturave atëherë bëhet me nënshkrimin e Shefit të Kontabilitetit dhe Menaxherit Rajonal Për Konsumator.

X

Aprovimin final të punës së komisionit e vendos Menaxhmenti i Lartë i Kompanisë.

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit të së njëjtës nga Bordi i Drejtorëve të K.R.U " Hidroregjioni Jugor" SH. A. – Prizren.

Datë : 03.02.2011
Prizren

KRU " Hidroregjioni Jugor" SH. A. – Prizren

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Mr. sci. Naser Bajraktari